KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.
I Nr. 242 Dt. 10/12/2014
PRISHTINË

Për: z. Enver Halimi
Kryesues i Bordit të Zyrës së
Rregullatorit për Energji
Rruga "Dervish Rozhaja"
nr.12 10000 Prishtinë

Nga:Arben Gjukaj
Drejtor Menaxhues
Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a.
Sheshi Nënë Tereza nr.36
Prishtinë 10000,
Republika e Kosovës
www.kek-energy.com

Datë: 10.12.2014

Lënda: Propozimi i KEK-ut për të hyrat maksimale për vitin 2015

I nderuar z. Halimi,

Më lejoni që fillimisht të ju falënderoj për inicimin e procesit të përshtatjeve vjetore për vitin e tretë relevant në kuadër të SHTE7.

Pas pranimit të shkresës suaj të datës 27 nëntor 2014, " Njoftimi mbi Azhurnimet vjetore të shqyrtimit të shtatë të tarifave të energjisë elektrike të cilat pritet të hyjnë në fuqi me 1 prill 2015". KEK ka përgatitur propozimin për të hyrat e lejuara maksimale për vitin e tretë relevant (2015), si dhe Propozimin për Çmimet e Gjenerimit për vitin 2015, konform Rregullës për Çmimet e Gjenerimit.

Bashkëngjitur me këtë shkresë do të gjeni:

- Propozimin e KEK-ut për Të Hyrat Maksimale të Lejuara për vitin 2015;
- Propozimin për Çmimet e Gjenerimit për vitin 2015;
- Raportin e llogaritjeve të KEK-ut për përshtatjen e komponentëve të Hyrave Maksimale të Lejuara për Vitin e ardhshëm Relevant;
- Formularët Raportues të ZRRE-së, të plotësuara nga KEK;

Korporata Energjetike e Kosovës është e përkushtuar që të ofrojë angazhimin e plotë që ky proces të përfundojë me sukses. Stafi i KEK-ut është në dispozicion dhe gatishmëri që të ofrojë informata shtesë për sqarimin e paqartësie të mundshme.

Me nderime,

Arben Gjukaj
Drejtor Menaxhues

KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a. – KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C. – PRISHTINË

Kopje për:

Anëtarët e Bordit të ZRRE-se,

Anëtarët e Bordit të KEK-ut,

Z.Salih Bytyqi, Drejtor Financiar, KEK

Z.Kujtim Hoxha, Drejtor për Çështje Rregullative, KEK

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES Sh. A.

Propozimi për ngarkesat e Gjeneratorit Publik

Dhjetor, 2014

Përmbajtja

1. Hyrje 3
2. Balanca e Energjisë Elektrike 4
2.1. Energjia Elektrike 4
2.2. Caku i disponibilitetit – Kapaciteti i disponueshëm 5
2.2.1. Termocentrali Kosova A 5
2.2.2. Termocentrali Kosova B 5
3. Të hyrat e lejeuara maksimale 7
3.1. Të hyrat e lejuara për Minierat 7
3.2. Të hyrat e lejuara për njësitë Gjeneruese 8
4. Alokimi i Kostove 9
4.1. Kostot Fikse 9
4.2. Kostot Variabile 10
5. Dizajni i ngarkesave 11
5.1. Ngarkesa për Energji 12
5.2. Ngarkesa për Kapacitet 12
6. Struktura Tarifore 13

1. Hyrje

Korporata Energjetike e Kosovës me datën 27 nëntor 2014 ka pranuar letrën njoftuese lidhur me fillimin e procesit të agjustimeve vjetore të shqyrtimit të shtatë të tarifave të energjisë elektrike.

Konform këtij njoftimi KEK ka përgatitur propozimin për të hyrat maksimale të lejuara për vitin e tretë relevant në kuadër të SHTE7 në përputhje me Rregullën për Çmimet e Gjenerimit. Propozimin për të hyrat maksimale të lejuara për vitin e tretë relevant përkatësisht për vitin 2015, KEK e dërgon në ZRRE me datën 10 dhjetor 2014.

Duke marrë në konsideratë se KEK është i obliguar që së bashku me Propozimin për të Hyrat e Lejuara për vitin 2015 të dërgojë në ZRRE për miratim edhe Ngarkesat e Gjeneratorit Publik të cilat pritet të aplikohen nga data 01 prill 2015.

Ngarkesat e Gjeneratorit të Rregulluar të paraqitura në këtë dokument, janë kalkuluar në përputhje me Metodologjinë për caktimin e çmimeve të gjeneratorit publik të miratuar nga ZRRE-ja në vitin 2014.

Përveç kostove tjera propozimi për ngarkesat e gjeneratorit publik ka marrë parasysh mirëmbajtjen e planifikuar gjatë vitit të ardhshëm dhe nivelin më të ulët të prodhimit sipas Draft Balancës vjetore të energjisë elektrike për vitin 2015 e cila pritet të miratohet nga MZHE.

KEK shpreson se ZRRE-ja do të trajtojë me kujdes të gjitha elementet e kostove të propozuara nga Gjeneratori i Rregulluar duke pas parasysh faktin se në vitin 2014 ka pasur kufizime financiare dhe kjo rrezikon një operim të mirëfilltë të njësive gjeneruse.

2. Balanca e Energjisë Elektrike

Balanca e Energjisë Elektrike është përgatitur nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT-i). Me qëllim të përgatitjes së Balancës Vjetor të Energjisë Elektrike, KOSTT-i ka marrë të dhëna dhe informata nga të gjitha palët relevante të përfshira në tregun e energjisë elektrike, duke përfshirë edhe Korporatën Energjetike të Kosovës.

Të dhënat dhe informatat të cilat KEK i ka dërguar në KOSTT për të kompletuar Balancën vjetore të energjisë elektrike e cila edhe është aprovuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik janë paraqitur në tabelën 1.

2.1. Energjia Elektrike

KEK gjithë energjinë elektrike të cilën e prodhon nuk e ka në dispozicion për shitje pasi që një pjesë të energjisë elektrike të prodhuar e harxhon për nevoja vetanake të termocentraleve si dhe një pjesë tjetër e shfrytëzon për nevojat e Divizioni të Prodhimit të Qymyrit. Duke pas parasysh këtë argument, për qëllimet e përcaktimit të ngarkesave përveç se kemi zbritur energjinë e cila shfrytëzohet (Harxhimi Vetanak) nga termocentralet, kemi bërë zbritjen e energjisë e cila konsumohet nga Divizioni i Prodhimit të Qymyrit në KEK. Këtë energji e kemi zbritur pasi që kostot e konsumit të kësaj energjie nuk i kemi paraqitur në MAR të Minierave, po që se kjo energji do të trajtohej si shitje nga Gjeneruesi, atëherë kostoja e shfrytëzimit të kësaj energjie do të duhej të përfshihej në MAR të Mihjeve. Sasia e energjisë elektrike e cila është paraparë të konsumohet nga DPQ-ja me Balancën e Energjisë Elektriketë është rreth 138GWh. Kjo sasi është reduktuar nga totali i energjisë së prodhuar në Prag nga TC Kosova A dhe TC Kosova B ashtu siç është paraqitur në tabelën 1. Ndërsa, kapaciteti dhe energjia e parashikuar të reduktohet rreh 49.48GWh nga TC Kosova B për Ko-gjenerim është reduktuar tek TC Kosova B siç paraqitet në tabelën e më poshtme.

Tabela 1.

Njësitë Gjeneruese	Viti 2015 Njësia	TC Kosova A	TC Kosova B	Total
Prodhimi në Gjenerator	MWh	2,141,949	4,193,244	6,335,193
Harxhimi Vetanak	MWh	214,933	310,671	525,604
Ko-Gjenerimi			49,488	49,488
Marrja nga Transmisioni	MWh	42,194	91,899	134,093
Neto Totali:	**MWh**	**1,884,822**	**3,741,186**	**5,626,008**
Konsumi i DPQ-së	**MWh**	138,000		
Energjia NETO	**MWh**	**5,488,008**		

2.2. Caku i disponibilitetit – Kapaciteti i disponueshëm

Kapaciteti i disponueshëm është sasia maksimale e energjisë elektrike të cilën njësitë gjeneruese mund ta prodhojnë në kushte specifike. Kapaciteti i njësive gjeneruese është përcaktuar nga prodhuesi i njësive gjeneruese dhe paraqet aftësinë e tyre për të prodhuar energjinë elektrike duke mos i tejkaluar kufizimet termike të dizajnuara nga prodhuesi. Varësisht nga disponueshmëria kohore e njësive gjeneruese prodhohet edhe sasia e energjisë elektrike (MWh).

Kapaciteti Neto gjatë sezonit të Verës dhe gjatë sezonit të Dimrit është i ndryshueshëm dhe zakonist përcaktohet nga testi i performancës i cili tregon ngarkesën maksimale të gjeneratorëve që mund të mbështesin në pikën e interkoneksionit gjatë sezonit përkatës. Temperaturat e ftohjes me ujë apo ajri i ambientit janë faktorët kryesorë që ndikojnë në ndryshimin e kapacitetit në mesë të sezonit të Verës dhe Dimrit.

Në kalkulimin e disponibilitetit janë marrë për bazë disa faktor relevant siç janë: orët e punes të njësive gjeneruese, orët të ndaljeve të pa'planifikuar si dhe kapaciteti i pritshëm në prag.

2.2.1. Termocentrali Kosova A

Në përcaktimin e disponibilitetit për njësitë gjeneruese të Termocentralit Kosova A kapacitetin e pritshëm e kemi marrë 120MW për orë, duke marrë parasysh se këto njësi gjeneruese varijojnë nga 120MW deri 140MW për orë.

Në bazë të kalkulimeve në tabelën 2, Caku i disponibilitetit për Termocentralin Kosova A pritet të jetë rreth 1,884,822MWh.

2.2.2. Termocentrali Kosova B

Në përcaktimin e disponibilitetit për njësitë gjeneruese të Termocentralit Kosova B kapacitetin e pritshëm e kemi marrë 265MW në përjashtim të disa muajve të verës (Qershor-Shtator) ku kemi marrë 260MW duke marrë parasyshë faktorët relevant të cilët ndikojnë siç janë kushtet klimatike dhe temperaturat e larta gjatë asaj kohe.

Në bazë të kalkulimeve në tabelën 2, Caku i disponibilitetit për Termocentralin Kosova B pritet të jetë rreth 3,790,654MW.

Gjithashtu në tabelën e më poshtme është paraqitur edhe kapaciteti i cili do të reduktohet për shkak të harxhimit vetanak marrja nga transmisioni si dhe kapaciteti i rezervuar për Ko-gjenerim të energjisë, që në total paraqet një zvogëlim të kapacitet në dispozicion prej 321,581 MW

Duke iu referuar tabelës 2, Kapaciteti i gjithmbarshëm i disponueshëm për Termocentralin Kosova A dhe Kosova B pritet të jetë rreth 5,353,895MWh.

Në tabelën 2, janë paraqitur të gjitha informatat e nevojshme për përcaktimin e cakut të disponibilitetit për vitin 2015. Kjo tabelë përmbanë informata për të gjitha njësitë gjeneruese të KEK Gjenerimit.

Tabela 2. Disponibiliteti

Bllloku	VITI 2015	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
		31 ditë	28 ditë	31 ditë	30 ditë	31 ditë	30 ditë	31 ditë	31 ditë	30 ditë	31 ditë	30 ditë	31 ditë	365 ditë
	Orë Pune brenda muajit	744	672	744	720	744	720	744	744	720	744	720	744	8760
	Numri i ndaljeve të planifikuara	-												
	Orët e ndaljeve të planifikuara	744 h	0 h	0 h	0 h	0 h	720 h	0 h	0 h	0 h	0 h	720 h	744 h	2928 h
A3	Numri i ndaljeve të pa planifikuara													
	Orët e ndaljeve të pa planifikuar	0 h	35 h	129 h	127 h	129 h	0 h	137 h	137 h	127 h	145 h	0 h	0 h	966 h
	Kapaciteti (MW)	120	120	120	120	120	120	120	120	120	120	120	120	
	Orët në Dispozicion	✗ 0	✓ 637.367	✓ 615.2	✓ 593.033	✓ 615.2	✗ 0	✓ 606.867	✓ 606.867	✓ 593.033	✓ 598.533	✗ 0	✗ 0	4866.1
	Totali i kapacitetit në dispozicion	0	76484	73824	71164	73824	0	72824	72824	71164	71824	0	0	583932
	Orë Pune brenda muajit	744	672	744	720	744	720	744	744	720	744	720	744	8760
	Numri i ndaljeve të planifikuara													
	Orët e ndaljeve të planifikuara	0 h	672 h	0 h	0 h	744 h	0 h	744 h	744 h	0 h	0 h	0 h	0 h	
A4	Numri i ndaljeve të pa planifikuara													
	Orët e ndaljeve të pa planifikuar	24 h	0 h	86 h	87 h	0 h	127 h	0 h	0 h	87 h	69 h	47 h	23 h	549 h
	Kapaciteti (MW)	120	120	120	120	120	120	120	120	120	120	120	120	
	Orët në Dispozicion	✓ 720.467	✗ 0	✓ 658.333	✓ 633.333	✗ 0	✓ 593.033	✗ 0	✗ 0	✓ 633.333	✓ 675	✓ 673.375	✓ 720.542	5307.4166667
	Totali i kapacitetit në dispozicion	86456	0	79000	76000	0	71164	0	0	76000	81000	80805	86465	636890
	Orë Pune brenda muajit	744	672	744	720	744	720	744	744	720	744	720	744	8760
	Numri i ndaljeve të planifikuara													
	Orët e ndaljeve të planifikuara	0 h	0 h	744 h	720 h	0 h	0 h	0 h	0 h	720 h	744 h	0 h	0 h	
A5	Numri i ndaljeve të pa planifikuara													
	Orët e ndaljeve të pa planifikuar	2 h	0 h	0 h	0 h	86 h	87 h	77 h	77 h	0 h	0 h	0 h	2 h	332 h
	Kapaciteti (MW)	120	122	120	120	120	120	120	120	120	120	124	120	
	Orët në Dispozicion	✓ 741.667	✓ 672	✗ 0	✗ 0	✓ 658.333	✓ 633.333	✓ 666.667	✓ 666.667	✗ 0	✗ 0	✓ 720	✓ 741.667	5500.333333
	Totali i kapacitetit në dispozicion	89000	82000	0	0	79000	76000	80000	80000	0	0	89000	89000	664000.064
	Orë Pune brenda muajit	**2232**	**2016**	**2232**	**2160**	**2232**	**2160**	**2232**	**2232**	**2160**	**2232**	**2160**	**2232**	**26280**
	Numri i ndaljeve të planifikuara													
	Orët e ndaljeve të planifikuara													
Total TC A	Numri i ndaljeve të pa planifikuara													
	Orët e ndaljeve të pa planifikuar	26 h	35 h	214 h	214 h	214 h	214 h	214 h	214 h	214 h	214 h	47 h	26 h	
	Kapaciteti (MW)	360	362	360	360	360	360	360	360	360	360	354	360	
	Orët në Dispozicion	1,462	1,309	1,274	1,226	1,274	1,226	1,274	1,274	1,226	1,274	1,333	1,462	
	Totali i kapacitetit në dispozicion	175,456	158,484	152,824	147,164	152,824	147,164	152,824	152,824	147,164	152,824	169,805	175,465	1,884,822
	Neto Kapaciteti i disponueshëm për TC Kosova A	175,456	158,484	152,824	147,164	152,824	147,164	152,824	152,824	147,164	152,824	169,805	175,465	1,884,822
	Orë Pune brenda muajit	744	672	744	720	744	720	744	744	720	744	720	744	8760
	Numri i ndaljeve të planifikuara													
	Orët e ndaljeve të planifikuara	0 h	0 h	0 h	216 h	0 h	0 h	72 h	624 h	0 h	0 h	216 h	0 h	
B1	Numri i ndaljeve të pa planifikuara													
	Orët e ndaljeve të pa planifikuar	38 h	37 h	38 h	10 h	38 h	25 h	1 h	0 h	25 h	38 h	10 h	38 h	297 h
	Kapaciteti (MW)	265	265	265	265	265	260	260	260	260	265	265	265	
	Orët në Dispozicion	✓ 706	✓ 635	✓ 706	⋮ 494	✓ 706	✓ 695	✓ 671	✗ 120	✓ 695	✓ 706	496	✓ 706	7335
	Totali i kapacitetit në dispozicion	187039	168335	187039	130927	187039	180804	174569	31173	180804	187039	130927	187039	1932734
	Orë Pune brenda muajit	744	672	744	720	744	720	744	744	720	744	720	744	8760
	Numri i ndaljeve të planifikuara													
	Orët e ndaljeve të planifikuara	0 h	0 h	0 h	504 h	336 h	0 h	0 h	264 h	288 h	0 h	0 h	0 h	
B2	Numri i ndaljeve të pa planifikuara													
	Orët e ndaljeve të pa planifikuar	38 h	37 h	38 h	4 h	8 h	25 h	38 h	24 h	0 h	38 h	25 h	38 h	314 h
	Kapaciteti (MW)	265	265	265	265	265	260	265	260	260	265	260	265	
	Orët në Dispozicion	✓ 706	✓ 635	✓ 706	✗ 212	⋮ 400	✓ 695	✓ 706	⋮ 456	⋮ 432	✓ 706	✓ 695	✓ 706	7054
	Totali i kapacitetit në dispozicion	187039	168335	187039	56112	105989	180804	187039	118458	112223	187039	180804	187039	1857920
	Orë Pune brenda muajit	**1488**	**1344**	**1488**	**1440**	**1488**	**1440**	**1488**	**1488**	**1440**	**1488**	**1440**	**1488**	**17520**
	Numri i ndaljeve të planifikuara													
	Orët e ndaljeve të planifikuara													
Total TC B	Numri i ndaljeve të pa planifikuara													
	Orët e ndaljeve të pa planifikuar	76 h	74 h	76 h	14 h	46 h	49 h	39 h	24 h	25 h	76 h	35 h	76 h	
	Kapaciteti (MW)	530	530	530	530	530	520	525	520	520	530	525	530	
	Orët në Dispozicion	1,412	1,270	1,412	706	1,106	1,391	1,377	576	1,127	1,412	1,189	1,412	
	Totali i kapacitetit në dispozicion	374,078	336,670	374,078	187,039	293,028	361,608	361,608	149,631	293,027	374,078	311,731	374,078	3,790,654
	Neto Kapaciteti i disponueshëm për TC Kosova B	374,078	336,670	374,078	187,039	293,028	361,608	361,608	149,631	293,027	374,078	311,731	374,078	3,790,654
	Total TC Kosova A dhe TC Kosova B	549,534	495,154	526,902	334,203	445,852	508,772	514,432	302,455	440,191	526,902	481,536	549,543	5,675,476
	Ko-Gjenerimi	8,928	8,064	5,952	2,400	-	-	-	-	-	3,600	8,640	11,904	49,488
	Harxhimi Vetanak - Marrja nga Transmisioni	14,515	13,162	14,510	9,432	10,843	11,370	11,230	7,233	6,920	10,033	10,210	14,635	134,093
	Kapacitetit për shfrytëzim të DPQ-së	12,000	12,000	12,000	11,000	11,000	11,000	11,000	11,000	11,000	12,000	12,000	12,000	138,000
	Cakut i Disponibilitetit	514,091	461,928	494,440	311,371	424,009	486,402	492,202	284,222	422,271	501,269	450,686	511,004	5,353,895

Caku i disponibilitetit i paraqitur në tabelën e më sipërme është përcaktuar në harmoni me nenin 16 paragrafi 3 të Rregullës për Çmimet e Gjenerimit si dhe Metodologjin për caktimin e ngarkesave të gjeneruesit publik.

3. Të hyrat e lejeuara maksimale

Në harmoni me Rregullën për Caktimin e Çmimeve të Gjenerimit, KEK ka përgatitur propozimin për të hyrat maksimale për vitin e tretë relevant, përkatësisht për vitin 2015 të cilën me datën 10 dhjetor 2014, e ka paraqitur në ZRRE për shqyrtim dhe miratim.
Duke marrë në konsideratë edhe pse viti kalendarik ende nuk ka përfunduar është dashur të mirren parasysh disa përafrime tek kostot e realizuar për vitin 2014, kështu në bazë të kalkulimeve fillestare propozimi për hyrat e lejuara maksimale për vitin 2015 arrin shumë prej €158.7 mln për Gjeneruesin Publik, duke përfshirë edhe Minierat.

3.1. Të hyrat e lejuara për Minierat

Të hyrat e lejuara për Miniera janë paraqitur si kostot e furnizimit me thëngjill për Gjeneruesin Publik. Prandaj, Propozimi i KEK-ut për të hyrat e lejuara apo kostot e furnizimit me thëngjill për vitin e dytë relevant janë propozuar në vlerë prej €83.99 mln të cilat do të mbulohen një pjesë nga ngareksa për energji dhe një pjesë do të mbulohet nga ngakresa për kapacitet.

Tabela 2. Kostot e Lejuara të Furnizimit me Thëngjill

Kostot e Mihjes	2015 € ('000)
Kostot e Personelit	23,814
Operimi dhe Mirëmbajtja	12,794
Zhvlerësimi	15,932
Kthimi	9,407
Renta e Thëngjillit	23,050
Derivatet - Lënd Djegëse	3,031
Sigurimi Shëndetësor 2014	700
Sigurimi Fizik	1,027
Transporti	100
Gas dhe Ujë	210
Axhustime Tjera	(6,069)
Total Mihjet	**83,994**

3.2. Të hyrat e lejuara për njësitë Gjeneruese

Në propozimin për të hyrat e lejuara maksimale për vitin e dytë relevant të SHTE7 kostot e TC Kosova A dhe TC Kosova B janë paraqitur si tërësi e kostove të Gjenerimit. Kostot të njësive gjeneruese duke i përjashtuar kostot e furnizimit me thëngjill janë €74.72 mln të cilat pritet të mbulohen nga ngarkesa për energji dhe ngarkesa për kapacitet.

Kostot e njësive gjeneruese janë paraqitur në mënyrë të detajuar në tabelën 3.

Tabeli 3. Kostot e njësive Gjeneruese

Kostot e Gjenerimit	2015 € ('000)
Kostot e Personelit	11,901
Operimi dhe Mirëmbajtja	7,415
Zhvlerësimi	23,308
Kthimi	9,293
Kostot e Bartshme (KOSTT dhe Licencat)	2,134
Derivatet - Lënd Djegëse	9,072
Sigurimi Shëndetësor 2014	309
Sigurimi Fizik	707
Transporti	150
Gas dhe Ujë	351
Axhustime Tjera	10,080
Total Gjenerimi A & B	**74,721**

4. Alokimi i Kostove

Alokimi i kostove të Gjenerimit në kostot fikse dhe kostot variabile është bërë në përputhje me Parimet për caktimin e ngarkesave për Gjenerim si dhe Rregullës për Çmimet e Gjenerimit. Të njëjtat parime janë përdorur edhe për Alokimin e kostove të Mihjeve duke iu referuar Nenit 14 paragrafi 5.2 të Rregullës për Çmimet e Gjenerimit.

Kostot fikse bazohen në kostot fikse të gjenerimit dhe të minierave, dhe ato kosto nuk ndryshojnë me vëllimin e energjisë së prodhuar.

Kostot variabile bazohen në kostot që nuk do të paraqiteshin në rast se njësit e furnizuara do të ishin zero. KEK-u ka ndjekur këtë parim në klasifikim e kostove. Prandaj, kostot e tjera operative dhe të mirëmbajtjes janë alokuar si 25% fikse dhe 75% variabile.

$$\textit{Të hyrat e lejuara} = \textit{Kostot Fikse} + \textit{Kostot Variabile}$$

4.1. Kostot Fikse

Komponenta e Kostove Fikse të Gjeneratorit të Rregulluar përfshinë të gjitha ato kosto që nuk varen nga niveli i prodhimit të impiantit energjetik. Të gjitha kostot fikse të Gjeneratorit të Rregulluar do të mbulohen nëpërmjetë ngakresës për Kapacitet. Kostot jane alokuar në përputhje me Metodologjin për Caktimin e Ngarkesave të Gjeneruesit Publik

Kostot fikse në këtë propozim janë kalkuluar sipas formulës në vijim:

$$FCG = PNC + INC + HQC + RTN + DEP + TPC + FMC$$

Ku

FCG	*paraqet komponentën fikse të kostove të gjeneratorit*
PNC	*paraqet kostot e stafit të kontraktuar që nuk ndryshon me nivelin e prodhimit të energjisë elektrike*
INC	*paraqet kostot e sigurimit shëndetësor*
HQC	*paraqet Kostot e Administratës qendrore*
RTN	*paraqet kthimin e lejuar në kapital*
DEP	*paraqet zhvlerësimin e lejuar*
TPC	*paraqet kostot e transportit të cilat nuk varen nga niveli i prodhimit*

4.2. Kostot Variabile

Kostot Variabile janë ato Kosto niveli i të cilave ndryshon me nivelin e prodhimit dhe përfshinë komponentën variabile të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes. Kostot jane alokuar në përputhje me Metodologjin për Caktimin e Ngarkesave të Gjeneruesit Publik

Kostot Variabile në këtë propozim janë kalkuluar sipas formulës në vijim:

$$VCG=CUT+CRM+CMS+CLU+OCT+VCM+FUC+PTC+LFC$$

Ku

VCG	*paraqet komponentën variabile të kostove të gjeneratorit*
CUT	*paraqet kostot e shërbimeve komunale dhe kostot e tjera që përdoren gjatë prodhimit të energjisë elektrike (ujë, energji elektrike etj.)*
CRM	*paraqet kostot e riparimeve të pajisjeve të dëmtuara dhe të mirëmbajtjes së pajisjeve të përdorura në prodhimin e energjisë elektrike*
CMS	*paraqet kostot e materialeve dhe furnizimeve*
CLU	*paraqet kostot e lubrifikimit të stabilimenteve energjetike*
OCT	*paraqet kostot e tjera që ndryshojnë me nivelin e prodhimit të energjisë elektrike*
VCM	*paraqet komponentën variabile të kostove të lejuara të minierës që do të llogariten si kostot që nuk do të ndodhnin sikur prodhimi i thëngjillit të ishte i barabartë me zero, të definuara sipas Nenit 6.4.2 të kësaj Metodologjie*
PTC	*paraqet kostot që barten*

Në tabelën 4 është paraqitur Alokimi i kostove në mënyrë të detajuar për secilën linjë për Mihje dhe për Gjenerim. Nga kjo tabelw shihet se 69% të kostove janë alokuar tek kostot fikse ndërsa 31% të kostove janë alokuar tek kostot variabile.

Tabela 4. Alokimi i kostove

2015	Kostot Fikse		Kostot Variabile		
Linja	Minierat € ('000)	Gjenerim € ('000)	Minierat € ('000)	Gjenerim € ('000)	Total € ('000)
Kostot e Personelit	23,814	11,901	-	-	35,715
Operimi dhe Mirëmbajtja	3,198	1,854	9,595	5,561	20,209
Zhvlerësimi	15,932	23,308	-	-	39,240
Kthimi	9,407	9,293	-	-	18,699
Renta e Thëngjillit	-	-	23,050	-	23,050
Kostot e Bartshme (KOSTT dhe Licencat)	-	-	-	2,134	2,134
Derivatet - Lënd Djegëse	-		3,031	9,072	12,103
Sigurimi Shëndetësor 2014	700	309	-	-	1,009
Sigurimi Fizik	1,027	707	-	-	1,734
Transporti	100	150	-	-	250
Gas dhe Ujë	-	-	210	351	561
Axhustime Tjera	(1,517)	10,080	(4,552)		4,011
Total KEK Mihje + Gjenerimi A & B	110,263		48,452		158,715

Alokimi i kostove në %	Kostot Fikse	Kostot Variabile	
	69.0%	31.0%	100.0%

5. Dizajni i ngarkesave

Pas vlerwsimit tw kostove fikse dhe varaibile mund të pwrcaktohet niveli i ngarkesave të gjeneratorit të rregulluar, të cilat do të aplikohen ndaj Furnizuesit Publik me Energji Elektrike me datë efektive duke filluar nga 1 prill 2015. Ngarkesat të cilat do të aplikohen ndaj FPEE-së janë:

- Ngarkesa për Energji dhe
- Ngarkesa për Kapacitet.

Ngarkesat e propozuara nga Gjeneratori i Rregulluar janë dizajnuar ashtu që të sigurohet së me aplikimin e tyre arrihen të hyrat e lejuara maksimale.

5.1. Ngarkesa për Energji

Ngarkesa për energji është dizajnuar në harmoni me Rregullën për Çmimet e Gjenerimit ku nëpërmjet saj synohet të mbulohen të gjitha kostot variabile të prodhimit të energjisë elektrike.

Kalkulimi i ngarkesës për energji bëhet sipas formulës në vijim:

$$\text{Ngarkesa për Energji} = \frac{\text{Kostot Variabile}}{\text{Energjia e Prodhuar}} = \frac{48{,}452}{5{,}488.01} = \mathbf{8.83}\ €/\text{MWh}$$

5.2. Ngarkesa për Kapacitet

Ngakresa për kapacitet është shprehur në euro për njësi të kapacitetit në dispozicion për orë. Kjo ngarkesë do të paguhet në bazë mujore për secilën orë të kapacitetit në dispozicion për atë muaj. Nëpërmjet saj synohet të mbulohen të gjitha kostot fikse për kapacitetin e ofruar në dispozicion nga njësitë gjeneruese duke plutësuar cakun e disponibilitetit.

Ngarkesa për kapacitet është dizajnuar në harmoni me nenin 16 paragrafi 2 të Rregullës për Çmimet e Gjenerimit.

Kalkulimi i ngarkesës për kapacitet bëhet sipas formulës në vijim:

$$\text{Ngarkesa për Kapacitet} = \frac{\text{Kostot Fikse}}{\text{Disponueshmëria MW/h}} = \frac{110{,}263}{5{,}353.90} = \mathbf{20.59}\ €/\text{MW/h}$$

6. Struktura Tarifore

Ngakresat e propozuara nga Gjeneratori Publik fillimisht do të shqyrtohen dhe aprovohen nga ZRRE-ja. Pas aprovimit të tyre, Gjeneratori i Rregulluar do ti aplikojë këto ngarkesa ndaj Furnizuesit Publik në përputhje me Marrëveshjen për furnizim me energji elektrike, me datë efektive nga 01 prill 2015.

Struktura Tarifore e Gjeneratorit të Rregulluar është paraqitur në mënyrë të detajuar me të gjitha elementet e saj në tabelën 6.

Tabela 6. Struktura Tarifore e Gjeneratorit të Rregulluar.

Elementet Tarifore	Njësia	Tarifa
Ngakresa për Energji	€/MWh	8.83
Ngarkesa për Kapacitet	€/MW/h	20.59

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

Propozimi për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Vitin e Tretë Relevant të SHTE7

10 dhjetor 2014

Përmbajtja

1 Hyrje 3

2 Struktura e dokumentit 4

3 Incidenti i ndodhur 5

5 Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) 7

5.1 Kostot e lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes (OPMCt) 8

5.2 Zhvlerësimi i lejuar (DEPCt) 9

5.3 Kthimi i lejuar në kapital (RTNCt) 10

5.4 Kostoja e lejuar e furnizimit me thëngjill (LGSCt) 12

5.5 Kostoja e Lëndëve të Tjera Djegëse (OTFCt) 14

5.6 Kostot e bartshme (PSTCt) 14

6 Të Hyrat e parregulluara dhe çështjet e tjera 15

6.1 Të hyrat e parregulluara 15

6.2 Rregullimi sekondar 15

6.3 Borxhet e kredive Qeveritare 16

7 Përmbledhje e propozimeve të KEK-ut për MAR 16

I. Shtojca 1.1: Llogaritja e Kostove të Lejuara të Furnizimit me Thëngjill LGSCt 18

II. Shtojca 1.2: Formularët Raportues 22

1 Hyrje

Dokumenti paraqet propozimin e Korporatës Energjetike të Kosovës për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për Vitin e tretë Relevant të Shqyrtimit të shtat të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE7). KEK-u përmes këtij dokumenti paraqet përshtatjet e rregullta të të gjitha kostove të lejuara nga ZRRE sipas Rregullës për vënien e çmimeve për gjeneratorin e rregulluar (neni 5). Pjesë e dokumentit janë formularët e raportimit për azhurnimet vjetore të kërkuara nga ZRRE-ja. Formularët paraqesin kostot e realizuara sipas komponenteve të caktuara të shpenzimeve. Pasiqë viti për të cilin po raportohet nuk është përfunduar ende, kostot e realizuara për muajt e mbetur janë paraqitur duke marrë në konsideratë pjesën e realizuar dhe një parashikim të arsyeshëm për pjesën e mbetur. KEK-u do të informojë ZRRE-në me kostot përfundimtare të realizuara.

Bazuar në analizat e bëra KEK konsideron se të Hyrat Maksimale për Vitin e Tretë Relevant SHTE7 duhet të arrijë vlerën prej 158.7 milionë euro, ashtu që KEK-u të jetë në gjendje të bëjë mirëmbajte dhe operim të mirë dhe të rregullt të njësive gjeneruese (Kosova A dhe Kosova B) dhe Mihjes.

2 Struktura e dokumentit

Dokumenti është strukturuar si vijon:

- Në kapitullin 3 është paraqitur kërkesa e KEK-ut për aksidentin e ndodhur dhe kërkesa e KEK-ut për pranimin e kostove të demëve të shkaktuara.
- Në kapitullin 4 jepet propozimi i KEK-ut për faktorin e aplikueshëm të efikasitetit për Gjeneratorin e Rregulluar;
- Në kapitullin 5 është dhënë përshkrimi i legjislacionit që përcakton nivelin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për Gjeneratorin e rregulluar;
- Në kapitullin 5.1 është dhënë propozimi për komponentin e shpenzimeve Operative dhe të Mirëmbajtjes;
- Në kapitullin 5.2 të dokumentit është dhënë propozimi për komponentin e zhvlerësimit;
- Në kapitullin 5.3 të dokumentit është dhënë propozimi për komponentin kthimit të lejuar;
- Në kapitullin 5.4 të dokumentit është dhënë propozimi për kostot e supozuara të furnizimit me thëngjill;
- Në kapitullin 5.5 të dokumentit është dhënë sqarimi për kostot e tjera të furnizimit me lëndë djegëse;
- Në kapitullin 5.6 të dokumentit është dhënë llogaritja për kostot e bartshme;
- Në kapitullin 6 janë paraqitur shënimet për të hyrat e parregulluara
- Në kapitullin 7 është dhënë një përmbledhje e propozimit të Korporatës Energjetike të Kosovës për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Vitin Relevant;

Të dhënat do të dorëzohen në fleta të punës me *Excel*, llogaritjet e dhëna për MAR janë përmbledhur në Shtojcën e këtij Dokumenti.

3 Incidenti i ndodhur

Korporata Energjetike e Kosovës, me datë 10.06.2014, ka dërguar në ZRRE kërkesën për shqyrtim te jashtëzakonshëm si pasojë e shpërthimit te ndodhur në repartin e elektrolizës te Termocentralit Kosova A dhe me datë 26.06.2014 shkresën me dëmët e shkaktuara nga aksidenti.

Komisioni profesional i KEK-ut ka përgatitur raportin final për dëmët e shkaktuara nga shpërthimi dhe KEK gjithashtu ka përgatitur dhe dërguar balancën e rishikuar të energjisë elektrike, me datë 24.06.2074, si pasojë e shpërthimit/aksidentit të ndodhur.

Sipas raportit të komisionit profesional dhe balancës së rishikuar te energiise elektrike vlera e dëmëve të Përgjithshmee të shkaktuara është mbi 11 % e vlerës së të Hyrave të Lejuara Maksimale. Dëmët e shkaktuara kanë ndikuar në zvogëlimin e prodhimit të energjisë elektrike sipas balancës vjetore të energjisë elektrike për 488 GWh me vlerë prej 15 464 470 Euro dhe dëmët në objektet e palëve të treta prej 200 000 Euro.

ZRRE me rastin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm nuk i ka marrë parasyshë dëmët e shkaktuara me konstatimin se "së pari të priten rezultatet e hetimit të shkakut të shpërthimit". KEK rithekëson rëndësinë që ka marrja parasyshë e dëmëve të shkaktuara për stabilitetin e domosdoshëm të KEK-ut.

Bazuar në të dhënat të paraqitura më lartë, gjithashtu të prezentuara edhe në shkresën e dërguar për shqyrtim të jashtëzakonshëm, shkresën për dëmet e shkaktuara, si dhe në Komentet e KEK-ut lidhur me Raportin konsultativ të shqyrtimit të jashtëzakonshëm të tarifave të energjisë elektrike në kuadër të SHTE8, KEK-u kërkon edhe një herë nga ZRRE që të pranojë të gjitha kostot e shkaktuara nga aksidenti (shpërthimi) i elektrolizës së TC Kosova A, në mënyrë që të mund të kryej të gjitha aktivitetet e domosdoshme si prodhues i licencuar i energjisë elektrike.

4. Faktori i efikasitetit

KEK-u ka shprehur brengen edhe më herët se faktori i efikasitetit i caktuar nga ZRRE është i paarritshëm, pasiqë që njësitë në operim (sidomos të TC Kosova A) janë në operim një kohë të gjatë (mbi 40 vite, njësitë e termocentralit Kosova A, ndërsa 30 vite të TC Kosova B). Faktori i efikasitetit është i lidhur me investimet të cilat e përmisojnë gjendjen e tanishme, si dhe me një kontrollë më të mirë të komponenteve që i nënshtrohen faktorit të efikasitetit.

Disa prej këtyre kostove janë shpenzimet e personelit, reduktimi i kostove të mirëmbajtjes apo ulja e shpenzimeve të tjera që janë të domosdoshme për funksionimin e përditshëm të korporatës si shpenzimet e tjera operative, shpenzimet e zyrës, transportit etj.

KEK-u siq është paraqitur në formularët raportues ka zvoglim të shpenzimeve në mirëmbatje dhe të shpenzimeve operative për shkak të aksidentit të ndodhur në elektrolizerin e termocentralit Kosova A dhe dëmtimeve në njësitë A4 dhe A5 të këtij termocentrali ka ndryshuar prodhimi i energjisë elektrike krahasuar me atë të parashikuar sipas balancës vjetore të energjsë, nga qershori (6 qershori) A4 dhe A5 të TC Kosova A janë jashtë operimit deri me 19 dhjetor 2014, ndërsa njësia A3 ka hy në operim në fillim të korrikut. Për këtë arsye nuk mund të kemi një pasqyrë të saktë krahasuese të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes për arsyet e paraqitura më lart.

Shpenzimet e personelit të KEK-ut janë vështirë të reduktueshme për këto arsye:

- Me shthurjen e KEK-ut një pjesë e stafit të kualifikuar ka kaluar në pjesën e KEDS-it (Operatori i sistemit të shpërndarjes dhe Furnizuesi Publik), kryesisht përsoneli i kuaifikuar dhe me përvojë i cili ka kryer detyrat e ndërlidhura të gjenerimit dhe furnizimit. Zëvendësimi i këtij stafi nënkupton punësimin dhe trajnimin e stafit të ri në një sektor që është tejet specifik dhe ku është e vështirë të gjenden kuadra të trajnuara. Kjo vështirësohet edhe më tepër për shkak të pagave mesatare të ulëta të Korporatës Energjetike të Kosovës krahasuar me akterët e tjerë në treg;
- Së dyti, KEK- është në proces të formimit të sektorëve ashtu që të mund të kryej detyrat si prodhues i energjisë elektrike - gjenerator i licencuar. Kjo ka të bëjë me sektorët të cilët do t'i mundësonin KEK-ut të veproj konfom kushteve të reja pas shthurjes dhe hapjes së tregut të energjisë elektrike të cilat do të kompletonin strukturën e KEK-ut, dhe
- Së treti, Korporata Energjetike e Kosovës është kompani publike që mban në vete një barrë të të brengave sociale. Edhe sikur vështirësitë që kanë të bëjnë me mungesën e stafit të kualifikuar

profesional të evitoheshin, barra sociale që – me apo pa të drejtë – i alokohet KEK-ut ia bën të vështirë të zbatojë masa rigoroze të rritjes së efikasitetit të personelit. Kostot e shpenzimeve të mirëmbajtjes është e lidhur ngusht gjendjen e njësive gjeneruese (vjetërsia e tyre), si dhe me mungesen e investimeve kapitale e të mirëmbajtjes në të kaluarën.

Me qenëse pas aksidentit (06.06.2014) dy njësi të termocentralit Kosova A ndodhen jashtë operimit (kjo ka shkaktuar zvoglimin e shpenzimeve), atëherë krahasimi i saktë me ato të realizuara në vitin e kaluar nuk mund të bëhet.

Duke pasur parasyshë arsyet e paraqitura më lartë KEK-u konsideron se nuk është në gjendje të arrijë efikasitetin të përcaktuar nga ZRRE gjatë shqyrtimit të saj. Zbatimi i saj vitet e kaluara ka rezultuar me humbje financiare në kohën kur KEK-u është në gjendje të vështirë financiare si pasojë e reduktimit në të hyra dhe si pasojë e humbjeve të shkaktuara nga aksidenti.

KEK rithekson rëndësinë e rishqyrtimit të faktorit të efikasitetit nga ZRRE për Vitin e tretë Relevant të SHTE7. Duke pasur parasysh kufizimet e KEK-ut për të rritur efikasitetin për shkak të argumenteve të dhëna më lart, konsiderojmë se aplikimi i faktorit të efikasitetit prej 1% për vit do të ishte i arsyeshëm për KEK-un.

MAR-i i llogaritur më poshtë ka marrë për bazë nivelin e efikasitetit prej 1% në OPMCt të Gjenerimit dhe të Mihjeve për vitin relevant 3.

5 Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR)

Llogaritja e vlerave për të Hyrat Maksimale të Lejuara për vitin e tretë Relevant Tarifor SHTE 7 të KEK-ut është bërë bazuar në parimet e dhëna në Rregullën për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar, që përcakton nivelin e të hyrave të cilat KEK-u mund të mbledhë nga zbatimi i ngarkesave të rregulluara.

Duke u bazuar në Nenin 5 të Rregullës [1] në dokument janë llogaritur ndryshimet në të Hyrat Maksimale të Lejuara të përcaktuara gjatë Shqyrtimit Periodik. Këto ndryshime janë llogaritur duke u bazuar në indeksimin e kostove të lejuara operative dhe të mirëmbajtjes me faktorin e efikasitetit të caktuar nga ZRRE, indeksimin të gjitha kostove të lejuara për të reflektuar inflacionin dhe azhurnimin e kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill. MAR po ashtu është përshtatur për të reflektuar nën-mbulimin dhe, në

[1] Rregulla për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar

raste të caktuara, mbi-mbulimin e kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill dhe të kostove të tjera që janë jashtë kontrollit të Gjeneratorit të Rregulluar.

Të hyrat e propozuara nga Rregullatori, të përmbledhura në pjesën 9 të këtij Dokumenti, kanë përdorur formulat e Shtojcës 1 të Rregullës për të vlerësuar MAR-in që duhet mbuluar nga Ngarkesat e Rregulluara në Vitin e ardhshëm Relevant.

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + LGSC_t + OTFC_t + PSTC_t$$

Ku

MAR_t	*paraqet Të hyrat e Lejuara Maksimale në Vitin Relevant t, të përmbledhura në kapitullin 5;*
$OPMC_t$	*paraqet Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t, të përshkruara në seksionin 5.1;*
$DEPC_t$	*paraqet Zhvlerësimin e lejuar në vitin relevant t, të përshkruar në shtojcën 5.2;*
$RTNC_t$	*paraqet Kthimin e lejuar në kapital në vitin relevant t, të përshkruar në seksionin 5.3;*
$LGSC_t$	*paraqet Kostot e lejuara të furnizimit të thëngjillit në vitin relevant t, të përshkruara në kapitullin 5.4;*
$OTFC_t$	*paraqet Kostot e lejuara të furnizimit me lëndë tjetër djegëse në vitin relevant t, të përshkruara në kapitullin 5.5;*
$PSTC_t$	*paraqet Kostot e bartshme në vitin relevant t, të përshkruara në kapitullin 5.6.*

5.1 Kostot e lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes (OPMCt)

Llogaritja e kostove të lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes për një vit të caktuar relevant realizohet sipas formulës në paragrafin 2.1 të Shtojcës 1 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar. Rregulla përcakton që kostot e lejuara për operim dhe mirëmbajtje të njësisë gjeneruese në një vit të caktuar relevant të jenë kostot që janë lejuar nga Rregullatori gjatë shqyrtimit periodik të tarifave, të përshtatura për të reflektuar vlerën aktuale të inflacionit në vitin e kaluar, faktorin e efikasitetit të caktuar nga ZRRE-ja për vitin relevant si dhe faktorin profilizues i cili në rastin konkret është caktuar të jetë zero. Formula e dhënë në paragrafin 2.1 të Rregullës është si vijon:

$$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$$

Ku

$OPMC_t$	*paraqet kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t*
$OPMC_{t-1}$	*paraqet kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant –t-1, përveç vitit relevant 1, ku do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit më të fundit periodik*
CPI_{t-1}	*paraqet Vlerën aktuale të inflacionit në vitin relevant t-1, të matur duke përdorur "Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) -- të gjitha njësitë, për Eurozonën" të publikuara nga Eurostat-i, apo ndonjë masë tjetër e inflacionit që rregullatori e përcakton të jetë si masa më e mirë e ndryshimit për kostot operative dhe të mirëmbajtjes përgjatë kohës dhe që lejohet gjatë shqyrtimit periodik*
E_t	*paraqet Faktorin e efikasitetit në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimit periodik dhe i cili është caktuar nga ZRRE të jetë 1%*
P_t	*paraqet Faktorin profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimit periodik dhe i cili është caktuar të jetë zero.*

$$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t) = 20.8 \text{ milion euro}$$

5.2 Zhvlerësimi i lejuar (DEPCt)

Sipas paragrafit 2.2 të Shtojcës 1 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar, zhvlerësimi i lejuar në çdo vit relevant *t* duhet të llogaritet duke indeksuar inflacionin në vlerën e zhvlerësimit të lejuar në vitin paraprak *t-1*.

$$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

Ku:

$DEPC_t$	*Paraqet zhvlerësimin tjetër të lejuar në vitin relevant t, i cili zbutet (sheshohet) ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative*
$DEPC_{t-1}$	*paraqet zhvlerësimin e lejuar në vitin relevant t-1, përveç vitit relevant 1 kur do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit periodik më të fundit, e cila zbutet ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullatore*

CPI_{t-1}	*paraqet vlerën aktuale të inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur "Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) -- të gjitha njësitë, për Eurozonën" publikuar nga Eurostat-i*
P_t	*paraqet faktorin profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimeve periodike*

Megjithatë, nëse zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant t ($DEPC_t$) llogaritet duke indeksuar zhvlerësimin e lejuar në vitin relevant t-1 atëherë shuma e MAR_t nuk do të arrijë vlerën e lejuar nga ZRRE gjatë shqyrtimit periodik SHTE7. Kjo për shkak se formula e $DEPC_t$ e dhënë në paragrafin 2.2 të Shtojcës së ZRRE-së supozon që zhvlerësimi do të profilizohet në mënyrë që ai të jetë konstant përgjatë tërë periudhës rregullatore (shih definicionin e $DEPC_{t-1}$). Meqë $DEPC_t$ dhe $RTNC_t$ (shih Seksionin 5.3) nuk janë profilizuar gjatë Shqyrtimit Periodik, llogaritja e saktë e $DEPC_t$-së për vitin e dytë relevant duhet të llogaritet duke indeksuar për inflacion vlerën e zhvlerësimit në $DEPC_{t-1}$, sipas praktikës së ZRRE-së, dhe duke i shtuar kësaj vlerën e lejuar të $DEPC_t$ të vitit të ardhshëm relevant:

$$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + DEPC_t = 23.3 \text{ milion euro}$$

5.3 Kthimi i lejuar në kapital (RTNCt)

Kthimi i lejuar në kapital është llogaritur sipas formulës së dhënë në paragrafin 2.3 të Shtojcës 1 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit.

$$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

Ku

$RTNC_t$	*Është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t, i cili zbutet (sheshohet) ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullative*
$RTNC_{t-1}$	*Është kthimi i lejuar në kapital në vitin relevant t-1, përveç vitit relevant 1 kur do të përdoret vlera e përcaktuar nga rregullatori gjatë shqyrtimit periodik më të fundit, e cila zbutet ashtu që të jetë konstant përgjatë periudhës rregullatore*
CPI_{t-1}	*është vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur "Indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP-të) – të gjitha njësitë, për Eurozonën" publikuar nga Eurostat-i*
Pt	*është faktori profilizues në vitin relevant t, i cili caktohet gjatë shqyrtimit periodik*

Rregulla ka paraparë që $DEPC_t$ dhe $RTNC_t$ të profilizohen në mënyrë që të zbuten ndikimet hyrjes në MAR të niveleve të larta të investimeve kapitale. Si në rastin e llogaritjes së zhvlerësimit të lejuar, rregulla specifikon që $RTNC_t$ të llogaritet duke e indeksuar për inflacion vlerën e RTNC në periudhën t-1. Siç është cekur më lart, kjo formulë supozon se në përcaktimin e $RTNC_t$-së në shqyrtimin periodik ZRRE ka aplikuar faktorin e profilizimit në mënyrë që RTNC të jetë konstant për çdo vit relevant t. Meqë RTNC nuk është profilizuar, llogaritja duhet të marrë parasysh indeksimin e inflacionit për lejesën e vitit të kaluar dhe kësaj duhet t'i shtohet kthimi i lejuar për vitin e ardhshëm relevant:

$$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + RTNC_t = 9.3 \text{ milion euro}$$

Tabela 1 Llogaritja e të hyrave maksimale për gjenerator

MAR per Gjeneratorin e Rregulluar (KSA+KSB)	2013	2014	2015
Faktori profilizues - Pt	0.0%	Euribor-i	0.58%
HICP Eurozona (17) Te gjitha njesite	0.7%	S-faktori	15.00%
Faktori i efikasitetit	1.0%	I	15.58%

OPMCt		t-2	t-1	t
		2013	2014	2015
OPMCt	€m	33.0	20.9	20.8
OTFCt	€m	8.3		
OPMCt-OTFCt	€m	24.8		
plus Efikasiteti dhe inflacioni SHTE7	€m	22.7		
OPMCt korrigjuar	€m	23.8	20.9	20.8

DEPCt		2013	2014	2015
DEPCt	€m	21.0	22.3	23.2
plus inflacioni	€m		22.3	23.3

RTNCt		2013	2014	2015
RTNCt	€m	8.0	8.8	9.2
plus inflacioni	€m		8.8	9.3

5.4 Kostoja e lejuar e furnizimit me thëngjill (LGSCt)

Propozimi i Gjeneratorit të Rregulluar për Kostot e Lejuara të Furnizimit me Thëngjill rregullohet me Nenin 11 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar. Propozimi i KEK-ut për këto kosto ndërmerret vetëm për qëllim të përcaktimit të Të Hyrave të Lejuara Maksimale të Divizionit të Gjenerimit dhe nuk paraqet paragjykim për rregullimin e furnizimit me thëngjill nga Rregullatori.

Propozimi për kostot e supozuara të furnizimit me thëngjill përfshin kostot e tantiemës së energjisë dhe i dorëzohet Rregullatorit për shkak se në kohën e hartimit të këtij Dokumenti Gjeneratori i Rregulluar nuk ka marrëveshje për furnizim me thëngjill, në pajtim me Nenin 11 paragrafin 2.2.1 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar.

Gjatë llogaritjeve të propozimit të kostove të lejuara të furnizimit me thëngjill, KEK-u ka përdorur të njëjtat parime si për përcaktimin e MAR-it të Gjeneratorit të Rregulluar, në pajtim me Nenin 11 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar. Kjo llogaritje ka marrë parasysh shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, zhvlerësimin dhe kthimin e lejuar të përcaktuar nga ZRRE gjatë Shqyrtimit Periodik. Kostot e supozuara të furnizimit me thëngjill janë përshtatur për të përfshirë inflacionin në pajtim me Nenin 11 paragrafin 5 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar.

Tabela në vijim paraqet llogaritjen e LGSCt-së nga KEK-u. Detajet e llogaritjes së kostos së lejuar të furnizimit me thëngjill janë dhënë në Shtojcë të këtij dokumenti.

Tabela 2 Llogaritja e Kostos së Lejuar të Furnizimit me Thëngjill (LGSCt)

Kostoja e Lejuar e Furnizimit me Thëngjill (LGSCt)		2013	2014	2015
Faktori profilizues - Pt		0.0%	Euribor-i	0.58%
HICP Eurozona (17) Te gjitha njesite		0.7%	S-faktori	15.00%
Faktori i efikasitetit		1.0%	I	15.58%
		t-2	t-1	t
OPMCt		2013	2014	2015
OPMCt	€m	42.2	42.0	41.5
plus Efikasiteti dhe inflacioni	€m	40.5	40.2	40.1
DEPCt		2013	2014	2015
DEPCt	€m	13.1	14.3	15.8
plus inflacioni	€m		14.4	15.9
RTNCt		2013	2014	2015
RTNCt	€m	8.5	9.3	10.7
plus inflacioni	€m		9.4	10.7
PSTCt		2013	2014	2015
PSTCt	€m	25.8	24.5	25.9
PSTCat-1	€m	22.1	22.1	
PSTCat-1 – PSTCft-1	€m	-3.7	-2.4	
plus interesi	€m		20.2	23.0
LGSCt	€m		84.2	89.8

5.5 Kostoja e Lëndëve të Tjera Djegëse (OTFCt)

Kostot e lëndëve të tjera djegëse të Gjeneratorit të Rregulluar llogariten gjatë përshtatjeve të Rregullta duke marrë parasysh edhe ndryshimin në mes të vlerës së parashikuar dhe asaj të realizuar të OTFC-së për Vitin e kaluar Relevant (t-1). Sipas paragrafit 2.1 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar, Kostoja e lëndëve të tjera Djegëse në çdo vit relevant t duhet të jetë:

$$OTFC_t = OTFCf_t + (OTFCa_{t-1} - OTFCf_{t-1}) * (1+ I_t)$$

Ku

$OTFC_t$	*paraqet kostot e tjera të furnizimit me lëndë djegëse për Vitin Relevant t*
$OTFCa_{t-1}$	*paraqet kostot e tjera të furnizimit me lëndë djegëse të realizuara në Vitin Relevant t-1*
OTFCft-1	*paraqet kostot e tjera të furnizimit me lëndë djegëse të lejuara për Vitin Relevant t-1*
It	*paraqet normën e interesit për Periudhën Relevante t, që llogaritet në bazë të EURIBOR-it plus S% ku S është vlera e caktuar nga Rregullatori gjatë Periudhës Rregullative dhe e cila reflekton preminë që duhet paguar nga i licencuari për kredi afat-shkurtra mbi normën e EURIBOR-it*

$$OTFC_t = OTFCf_t + (OTFCa_{t-1} - OTFCf_{t-1}) * (1+ I_t) = 9.1 \text{ milionë euro}$$

5.6 Kostot e bartshme (PSTCt)

Kostot e bartshme të Gjeneratorit të Rregulluar paraqesin shumën e kostove të lejuara për shërbimet e operatorit të sistemit dhe të transmisionit si dhe ndryshimin në mes të vlerave të lejuara dhe të realizuara të këtyre kostove për vitin relevant t-1.

Sipas paragrafit 2.6 të shtojcës 1 të Rregullës për vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar, kostot e barrshme në çdo Vit Relevant t duhet të jenë:

$$PSTC_t = PSTCf_t + (PSTCa_{t-1} - PSTCf_{t-1}) * (1+ I_t)$$

Ku

$PSTC_t$	*janë kostot e bartshme në vitin relevant t*
$PSTCa_{t-1}$	*janë kostot e bartshme të realizuara në vitin relevant t-1*
$PSTCf_{t-1}$	*janë kostot e bartshme të parashikuara për vitin relevant t-1*
It	*është norma e interesit për Periudhën Relevante t, që llogaritet në bazë të EURIBOR-it plus S% ku S është vlera e caktuar nga Rregullatori gjatë Periudhës Rregullative dhe e cila reflekton preminë që duhet paguar nga i licencuari për kredi afat-shkurtra mbi normën e EURIBOR-it*

$$PSTC_t = PSTCf_t + (PSTCa_{t-1} - PSTCf_{t-1}) * (1+ I_t)=$$

$$=3.9+(3.9-2.6)*(1+0.1558)=2.1 \text{ milionë euro}$$

6 Të Hyrat e parregulluara dhe çështjet e tjera

Llogaritjet e lartshënuara paraqesin llogaritjen e MAR-it për Vitin e ardhshëm Relevant sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1 të Rregullës për Vënien e Çmimeve të Gjeneratorit të Rregulluar. Sipas paragrafit të parë të Shtojcës 1, formulat e paraqitura kanë për qëllim të plotësojnë parimet e prezantuara në pjesën kryesore të Rregullës. Sa për informim të ZRRE-së, MAR-i i propozuar nga KEK-u nuk përfshin çështjet e listuara në vijim. KEK-u pret që këto çështje të shqyrtohen dhe zgjidhen në ditët në vijim para përcaktimit të të Hyrave Maksimale të Lejuara për Vitin e ardhshëm Relevant.

6.1 Të hyrat e parregulluara

Në praktikë, në të kaluarën, ZRRE ka përshtatur MAR-in e të licencuarve për të reflektuar të ardhurat shtesë që të licencuarit mund t'i përfitojnë në raport me shitjet ndaj palëve të treta. Kjo përshtatje nuk është përfshirë në propozimin e KEK-ut por të dhënat e nevojshme janë dhënë në Formularët Raportues, të cilët i dorëzohen ZRRE-së krahas këtij Raporti.

6.2 Rregullimi sekondar

KEK-u është në proces të përcaktimit të analizës dhe vlerësimit financiar për realizimin e rregullimit sekondar si shërbim ndihmës për KOSTT. Si të përfundoj vlerësimi financiar KEK-u do të dërgoj në ZRRE dokumentin e këtij vlerësimi, kostot e të cilit duhet të merren parasyshë për të mundësuar funksionimin e rezervës skondare.

6.3 Borxhet e kredive Qeveritare

KEK-u e ka paraqitur edhe vitin e kaluar shqetësimin për kreditë e marra nga Qeveria e Kosoves. Për këtë arsye KEK në Vitin e ardhshëm Relevant rrezikon të operojë në humbje edhe për shkak të pagesave të interesit në kreditë e marra nga Qeveria e Kosovës. Ende nuk ka zhvillime sa i përket vendimit nga Komiteti Ndërministror lidhur me këtë çështje. Kjo çështje është adresuar edhe vitin e kaluar nga KEK. Kërkojmë që edhe ky problem të merret parasysh gjatë përcaktimit të të hyrave maksimale të lejuara për Vitin e ardhshëm Relevant.

7 Përmbledhje e propozimeve të KEK-ut për MAR

Sipas formulës së MAR të dhënë në Kapitullin 5 të këtij Dokumenti, Të Hyrat Maksimale të Lejuara që janë të nevojshme për operimin normal të KEK-ut, pas aplikimit të faktorit të efikasitetit prej 1%, janë 158.7 milionë euro. Llogaritja është dhënë në Tabelën në vijim:

Tabela 3 Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a.

MAR per Gjeneratorin e Rregulluar (KSA+KSB)	2013	2014	2015
Faktori profilizues - Pt	0.0%	Euribor-i	0.58%
HICP Eurozona (17) Te gjitha njesite	0.7%	S-faktori	15.00%
Faktori i efikasitetit	1.0%	I	15.58%

OPMCt		t-2	t-1	t
		2013	2014	2015
OPMCt	€m	33.0	20.9	20.8
OTFCt	€m	8.3		
OPMCt-OTFCt	€m	24.8		
plus Efikasiteti dhe inflacioni SHTE7	€m	22.7		
OPMCt korrigjuar	€m	23.8	20.9	20.8

DEPCt		2013	2014	2015
DEPCt	€m	21.0	22.3	23.2
plus inflacioni	€m		22.3	23.3

Propozimi për të hyrat maksimale të lejuara për vitin 2015

RTNCt

		2013	2014	2015
RTNCt	€m	8.0	8.8	9.2
plus inflacioni	€m		8.8	9.3

LGSCt

		2013	2014	2015
LGSCt	€m	87.8	76.8	89.0
LGSCft-1	€m	87.8	76.8	
LGSCat-1	€m	71.5	72.5	
plus interesi	€m		76.8	84.0

OTFCt

		2013	2014	2015
OTFCt	€m	8.3	6.3	8.3
OTFCft-1	€m	8.3	6.3	
OTFCat-1	€m	4.3	7.0	
plus interesi	€m		6.3	9.1

PSTCt

		2013	2014	2015
PSTCt	€m	3.9	3.5	3.0
PSTCft-1	€m	3.9	3.5	
PSTCat-1	€m	2.7	2.7	
plus interesi	€m		3.5	2.1

MAR korrigjuar	152.8	138.6	148.6
Adjustment		0.9	10.1
MAR Final	152.8	139.5	158.7

I. Shtojca 1.1: Llogaritja e Kostove të Lejuara të Furnizimit me Thëngjill LGSCt

Në këtë shtojcë jepen detajet e llogaritjes së kostos së lejuar të furnizimit me thëngjill të cilat, sipas kapitullit 5.4 të këtij Dokumenti, janë vlerësuar të jenë 89.8 milionë euro.

Pasi që ende nuk ekzistonë një marrëveshje ndërmjet një kompanie pëër prodhimin e thëngjillit dhe gjeneratorit të rregulluar është bërë llogaritja e LGSCt-së.

Gjatë llogaritjes së LGSCt-së KEK ka supozuar se kompania e mihjeve është kompani normale komerciale. Në llogaritjen e MAR të LGSCt-së, KEK ka supozuar të njëjtat parime si ato të Gjeneratorit të Rregulluar, përveç aplikimit të kostove që mund të jenë specifike për njërin entitet apo për tjetrin.

Ndryshe nga Divizioni i Gjenerimit, në llogaritjen e kostove të lejuara për mihje është përdorur ekuacioni në vijim:

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + PSTC_t$$

Ku

MAR_t	*paraqet Të hyrat e Lejuara Maksimale në Vitin Relevant t*
$OPMC_t$	*paraqet Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t*
$DEPC_t$	*paraqet Zhvlerësimin e lejuar në vitin relevant t*
$RTNC_t$	*paraqet Kthimin e lejuar në kapital në vitin relevant t*
$PSTC_t$	*paraqet Kostot e bartshme në vitin relevant t*

Pra Kostot e lejuara (MARt) janë vlerësuar si shuma e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes, zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar gjatë shqyrtimit periodik (pa profilizim) dhe kostove të bartshme (pass-through) në periudhën relevante t.

Llogaritja e OPMC-së

Mënyra e llogaritjes së shpenzimeve operative dhe të mirëëmbajtjes të diviziopnit të Mihjeve është bërë njëjtë si për gjeneratorin e rregulluar.Llogaritja e OPMCt-së për Divizionin e mihjeve është dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 4 Kostoja e lejuar e furnizimit me thëngjill e Gjeneratorit të Rregulluar (OPMCt)

Kostoja e Lejuar e Furnizimit me Thëngjill (LGSCt)	2013	2014	2015
Faktori profilizues - Pt	0.0%	Euribor-i	0.58%
HICP Eurozona (17) Te gjitha njesite	0.7%	S-faktori	15.00%
Faktori i efikasitetit	1.0%	I	15.58%

OPMCt		t-2	t-1	t
		2013	2014	2015
OPMCt	€m	42.2	42.0	41.5
plus Efikasiteti dhe inflacioni	€m	40.5	40.2	40.1

Llogaritja prej 40.1 milionë eurosh është bërë si vijon:

1. Vlerës së OPMCt-së të lejuar për vitin Relevant 2 (42 milionë euro) i është aplikuar faktori i efikasitetit (4%);
2. Vlerës rezultuese prej 40.2 miliionë eurosh i është shtuar inflacioni;
3. Shumës së vlerës rezultuese nga numri 2 dhe diferencës në mes të OPMCt-së në periudhën relevante t dhe t-1 (pa inflacion) i është aplikuar faktori i efikasitetit prej 1%.

OPMCt=(42*(1-0.04))*0.07+(40.2-42)]*(1-0.01)=40.1 milionë euro.

Llogaritja e DEPCt-së

Zhvlerësimi i lejuar është llogaritur si në rastin e Divizionit të Gjenerimit. Kostoja e lejuar e zhvlerësimit, si në rastin e mëparshëm, nuk është profilizuar siç kërkohet nga Rregulla për Vënien e Çmimeve të Gjenerimit, prandaj kjo ka pamundësuar aplikimin e formulës së Zhvlerësimit në mënyrë strikte:

$$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

Aplikimi i kësaj formule në mënyrën e kërkuar nga Rregulla do të rezultonte në LGSCt që nuk është e barabartë me MARt-në e supozuar nga ZRRE gjatë shqyrtimit periodik. Prandaj, si në rastin e Gjenerimit, KEK propozon që llogaritja të bëhet duke aplikuar HICP-në në DEPCt-1 dhe duke i shtuar kësaj vlerën e DEPCt që është lejuar per Vitin e dytë Relevant gjatë Shqyrtimit Periodik. Rezultati i kësaj llogaritjeje është 14.3 milionë euro:

$$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + DEPC_t =$$

$$=14.3*0.007+15.8=15.9 \text{ milionë euro}$$

Llogaritja e RTNCt-së

Kostoja e lejuar e kthimit në investime kapitale është llogaritur me të njëjtin parim si ajo e Gjeneratorit të Rregulluar. Meqë RTNCt nuk është profilizuar siç kërkohet në Shtojcën 1 të Rregullës, llogaritja e RTNCt-së ka përdorur të njëjtën metodologji si ajo e DEPCt-së. RTNCt që i shtohet LGSCt-së së Gjeneratorit të Rregulluar rezulton të jetë 9.3 milionë euro.

$$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + RTNC_t =$$

$$=9.3*(0.007)+10.7=10.7 \text{ milionë euro.}$$

Llogaritja e PSTCt-së

Kostot e bartshme të Divizionit të Mihjeve përfshijnë kostot e tantiemës për thëngjill dhe taksat e licencës. Sipas paragrafit 2.6 të Shtojcës 1 të Rregullës, kostoja e bartshme në çdo Vit Relevant t duhet të marrë parasysh vlerën e parashikuar për atë vit Relevant gjatë Shqyrtimit Periodik por kësaj vlere duhet t'i shtohet diferenca në mes të kostove të bartshme të realizuara në vitin relevant t-1 dhe atyre të lejuara për atë vit relevant:

$$PSTC_t = PSTCf_t + (PSTCa_{t-1} - PSTCf_{t-1}) * (1+ I_t)$$

PSTCt=23.0 milionë euro.

Përmbledhje e LGSCt-së

Tabela 5 Kostoja e lejuar e furnizimit me thëngjill (LGSCt)

Kostoja e Lejuar e Furnizimit me Thëngjill (LGSCt)

	2013	2014	2015
Faktori profilizues - Pt	0.0%	Euribor-i	0.58%
HICP Eurozona (17) Te gjitha njesite	0.7%	S-faktori	15.00%
Faktori i efikasitetit	1.0%	I	15.58%

OPMCt

		t-2	t-1	t
		2013	2014	2015
OPMCt	€m	42.2	42.0	41.5
plus Efikasiteti dhe inflacioni	€m	40.5	40.2	40.1

DEPCt

		2013	2014	2015
DEPCt	€m	13.1	14.3	15.8
plus inflacioni	€m		14.4	15.9

RTNCt

		2013	2014	2015
RTNCt	€m	8.5	9.3	10.7
plus inflacioni	€m		9.4	10.7

PSTCt

		2013	2014	2015
PSTCt	€m	25.8	24.5	25.9
PSTCat-1	€m	22.1	22.1	
PSTCat-1 – PSTCft-1	€m	-3.7	-2.4	
plus interesi	€m		20.2	23.0
LGSCt	**€m**		**84.2**	**89.8**

II. Shtojca 1.2: Formularët Raportues